



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:091334  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05524780

**PAKR.nr.56/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afërdita Bytyçi - kryetare e kolegjit, Vatton Durguti dhe Kadrije Goga Lubishtani – anëtar të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarit, B.K., për shkak të veprës penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës– në vijim KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.739/2014 të datës 10.01.2024, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër të lëndës PKR.nr.619/2014 të datës 22.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë 01.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si të pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.739/2014 të datës 10.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.619/2014 të datës 22.12.2023, **VËRTETOHET**.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.619/2014 të datës 22.12.2023, të akuzuarin B.K., e ka liruar nga aktakuza pasi që, nuk është provuar se ka kryer veprën penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të KPRK-së.

Të akuzuarit B.K.duhet t'i kthehet telefoni Nokia 2220s, me numër IMEI ... me SIM kartelë Vala, me numër 044/...-..., i sekuestruar nga policia me datë 10.07.2014, pasi nuk është vërtetuar se është përdorur për kryerjen e veprës penale e as përfituar me kryerjen e veprës penale si më lart.

Shpenzimet gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarin B.K. ta shpall fajtor për veprën penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të KPRK-së ose çështjen ta kthej në rigjykim.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/II.nr.71/2024, datë 31.01.2024 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda të aprohet ashtu që aktgjykimin i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit ose aktgjykimin të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së, në të cilën ka prezantuar i akuzuari B.K. dhe mbrojtësi i tij av. B.K. ndërsa nuk ka prezantuar askush nga Prokuroria e Apelit edhe pse ka qenë i njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit gjyqësor dhe shqyrtoj shkresat e lëndës, gjithashtu vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

### **Pretendimet e Prokurorisë në ankesë**

Në ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë thekson se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda me rastin e marrjes së aktgjyimit lirues për të akuzuarin B.K., për veprën penale Kultivim i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par. 1 të KPRK-së, nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike kur të akuzuarin e ka liruar nga aktakuza, ngase Prokuroria Gjykatës i ka prezantuar prova të mjaftueshme, të cilat po ti vlerësonte drejtë Gjykata do të vërtetohej se i akuzuari i lartcekur B.K. ka kryer veprën penale Kultivim i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par. 1 të KPRK-së, për të cilën është akuzuar si në aktakuzë. Tutje shton se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljen e ligjit penal, me rastin e marrjes së aktgjyimit lirues. Sipas Prokurorisë, aktgjykimi i ankimuar është jo i drejtë dhe i pabazuar dhe nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë provat të cilat Prokuroria i ka propozuar në aktakuzë të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor e me të cilat prova vërtetohet gjendja faktike ashtu siç është cekur në aktakuzë, se në veprimet e të akuzuarit B.K. qëndrojnë të gjitha elementet esenciale të veprës penale Kultivim i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për arsye se i njëjti me tani të gjykuarit K.K., Q.K., A.K. dhe F.K. kishin kultivuar bimën e kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikëve, ashtu që fillimisht ishte furnizuar me fara të kanabisit e pastaj të njëjtat i kishte mbjellur në katër plantacione në thellësi të pyllit të fshatit Majac, Komuna e Podujevës ndërsa me datë 03.07.2014 rreth orës 19:00 i kishin prashitur, ujitur dhe plehëruar me qëllim që më vonë ti posedojnë dhe ti përdorin këto bimë për përgatitjen, përpunimin, ambalazhimin dhe për procese të tjera për përfitim final të 1448 fijeve të kanabisit, e të cilat ishin sekuestruar nga Policia e Kosovës, Njësi për Hetimin e Narkotikëve. Prokuroria konsideron se aktgjykimi i ankimuar me të cilin gjykata e shkallës së parë e ka liruar nga aktakuza të akuzuarin B.K. për veprën penale Kultivim i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par. 1 të KPRK-së, ky aktgjykim lirues është jo i drejtë, i pabazuar, dhe me këtë aktgjykim Gjykata ka bërë shkeljen e

ligjit penal kur të akuzuarin e lartcekur e ka liruar nga Aktakuza për veprën penale të lartëcekur. Mbi këto rrethana Prokuroria ka propozuar si më lartë.

#### Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit analizoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se janë të pabazuara pretendimet ankimore përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga dispozita e nenit 384 të KPPRK-së, të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, për më tepër, Prokuroria në drejtim të pretendimit ankimor lidhur me këtë bazë në ankesë nuk thekson se në cilën pjesë dhe ku konsistojnë shkeljet në të cilat është marrë aktgjykimi i ankimuar. Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqenëse dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu, pra, konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPP-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto provat ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se që gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari B.K. të ketë kryer veprën penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkures së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të KPRK-së, me ç'rast gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ligjshëm duke marrë aktgjykim me të cilin të akuzuarin e ka liruar nga akuzua për të cilën është akuzuar nga prokuroria.

Kjo për faktin se, kolegji penal në këtë çështje penale, vlerëson si të drejta përfundimet e shkallës së parë e që deri tek kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave personale si: *dëshmia e dëshmitarit K.K.*, i cili ndër të tjera, ka deklaruar se B.K. e njeh si bashkëfshatar prej që jeton në fshatin Majac, duke shtuar se është gjykuar për këtë rast, pasi narkotikun e ka mbjellë ai- dëshmitari, i cili e ka pranuar fajësinë për veprën penale dhe është penduar.

Nga dëshmia e dëshmitari K., i cili ka dëshmuar se B.K. nuk ka të bëj me narkotikët për të cilët po akuzohet, duke theksuar se në kohën kur ka ndodhur rasti, B.K. ka pasur veturë Golf 2, nuk e di çfarë ngjyre, por e di se duke dalë nga shtëpia e tij në rrugë, në kohën e iftarit, ja ka qitë dorën B., i cili e ka ndalë veturën dhe e ka marrë e pastaj së bashku kanë shkuar në shitore për të blerë bukë, ndërsa gjatë kthimit nga shitorja i kanë ndaluar policia në fshatin Majac dhe i kanë arrestuar, por data e saktë nuk i kujtohet, duke shtuar se policia nuk iu ka treguar për arsyen e ndalimit, por më vonë e ka kuptuar se e kanë ndaluar për shkak të bimëve narkotike, bimë të cilat në momentin e ndalimit nuk i ka pasur me vete. Ndërsa më tej, dëshmitari K.K., ka theksuar se bimët narkotike të gjetura në fshatin Majac e të paraqitura si në aktakuzë, për të cilat është shpallur fajtor, i ka mbjellë ai, Q., A. dhe F., ndërsa B.K. nuk ka pasur njohuri për këto bimë. Pra, nga *dëshmia e dëshmitarit K.K.* nuk rezulton se i akuzuari B.K. të ketë ndërmarrë ndonjë veprim inkriminuese në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar, për të tepër ky dëshmitar nën betim ka deklaruar se bimët narkotike të gjetura në fshatin Majac e të paraqitura si në aktakuzë, i ka mbjellë ai, Q., A. dhe F., ndërsa B.K. nuk ka pasur njohuri për këto bimë.

Po ashtu dëshmitari, F.K., ka deklaruar se e njeh B.K. si bashkëfshatarë dhe si prind i A.K., derisa ai me vëllezërit e tij dhe me A.K. kanë kultivuar hashish në mal në fshatin Majac, duke u arsyetuar se kanë qenë të ri dhe kanë gabuar, duke shtuar më tej se B.K. e ka pasur një veturë Golf 2, nuk i kujtohej çfarë ngjyre, e po ashtu edhe data e saktë nuk i kujtohej, se në atë kohë nuk i kujtohet që e ka parë B.K., duke shtuar se në atë kohë nga Policia është arrestuar me dy vëllezërit e tij K. dhe Q. si dhe me A.K., për kultivimin e narkotikut, për të cilin është shpallur fajtor dhe është penduar, ku më tej ka deklaruar se shtëpia e B.K. është larg shtëpisë së tij rreth 1.5 – 2 km dhe se gjatë kultivimit të bimëve narkotike, ai nuk e ka parë asnjëherë B.K. në vendin ku janë kultivuar këto bimë.

Për më tepër, edhe nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë, siç janë: Fotoalbumi i vendit të ngjarjes, në të cilin shihen tani të gjykuarit K.,

Q., A. dhe F.K., duke kultivuar bimët narkotike të përshkruara në dispozitivin e aktakuzës; Lista e konfiskimit të telefonit dhe SIM kartelës nga i pandehuri B.K., me të cilën nuk vërtetohet ndonjë fakt relevant se i akuzuari B.K. ka kryer veprën penale si më lart; Procesverbali i bastisjes së banesës dhe lokaleve të N.K., përkatësisht K. e Q.K., nuk ka të bëjë me të akuzuarin B.K.; Procesverbali i bastisjes së banesës dhe lokaleve të pandehurit B.K., i datës 10.07.2014 sipas të cilit në shtëpinë e tij nuk kanë gjetur asgjë përpos që kanë sekuestruar dokumente të udhëtimit – pasaporta; Informata e Drejtorisë për hetimin e trafikimit të narkotikëve - DHTN e datës 09.07.2014, sipas së cilës katër persona kultivojnë bimë narkotike; CD-të, të cilat nuk janë shikuar sepse nuk kanë qenë të bashkëngjitura me shkresat e lëndës PKR.nr.619/2014 e as me ato të lëndës PKR.nr.543/2014 në të cilën është bërë veçimi i procedurës penale, në këtë çështje penale, dhe Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë- AKF, nr. AKF/2014-2715/2014-2374 i datës 05.09.2014, sipas të cilit bari narkotik i përket kanabisit me përbërje tetrahidrokanabinol (THC) nuk është vërtetuar se i akuzuari B.K. ka ndërmarrë ndonjë veprim i cili do ta implikonte në veprën penale për të cilën ngarkohej me aktakuzë nga Prokuroria e shtetit.

Andaj, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e prokurorisë të paraqitura në ankesë janë të pabazuara ngase pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës rezulton se me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk vërtetohet fakti se i pandehuri B.K., ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës.

Sa i përket pretendimit ankimor të shkeljes së ligjit penal me pretendim se ekzistojnë prova të mjaftueshme në bazë të cilave gjykata duhej ta shpallte fajtor dhe ta dënonte të akuzuarin për veprën penale që ngarkohet kjo Gjykatë e gjen të pabazuar për faktin se nga provat e administruara nuk kanë rezultuar si të provuara tiparet e veprës penale për të cilën i njëjti është akuzuar dhe as që kanë qenë të përshkruara veprimet inkriminuese në dispozitiv që do të përbënin figurën e veprës penale për të cilën është akuzuar i akuzuari, andaj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se nuk është provuar me asnjë provë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar e pranon edhe kjo Gjykatë si të drejtë dhe ligjor ndërsa pretendimet e prokurorisë si në ankesë i refuzoi si të pabazuara meqenëse aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.56/2024, datë 01.03.2024**

**Bashkëpunëtore Profesionale,**

\_\_\_\_\_  
**Gresë Latifi**

**Kryetare e kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Afërdita Bytyçi**

**Vaton Durguti**

\_\_\_\_\_  
**Kadrije Goga Lubishtani**